



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 335/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitura ndaj subjekteve politike Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të dyja me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së paautorizuar të materialit promovues politik-poster/baner reklamues, në ndërtesën e banimit kolektiv në pronësi private, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat e evidentuara si: Anr.335/2019, Anr.336/2019, Anr.337/2019, Anr.338/2019, dhe Anr.339/2019, të gjitha të datës 07.10.2019, të paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjekteve politike Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të dyja me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së paautorizuar të materialit promovues politik-poster/baner reklamues, në ndërtesën e banimit kolektiv në pronësi private,

A r s y e t i m

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP, ankesat: Anr.335/2019, dhe Anr.339/2019, të datës 07.10.2019, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe ankesat Anr.336/2019, Anr.337/2019, dhe Anr.338/2019, poashtu të datës 07.10.2019, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të dyja me seli në Prishtinë, me të cilat ka pretenduar, se nga ana e subjekteve politike në fjalë, respektivisht degët e tyre në qytetin e Ferizaj-it, në kundërshtim me dispozitat e LZP-së, si dhe në dëm të garës së ndershme për zgjedhjet e 6 tetorit, janë ndërmarrë veprime të dënueshme, ashtu që në ndërtesën e banimit kolektiv në pronësi private, në Rr.” Hamëz Jashari”, pa marrë pëlqimin përkatës të pronarit/pronarëve të ndërtesës/njësive banesore afariste, është bërë vendosja e materialit promovues – poster/baner reklamues të dimensionit të madh të kandidatit Dardan Bibaj nga radhët e subjektit politik LDK, dhe veprimi i njëjtë është marrë edhe në Rr.”Ahmet Kaçiku” dhe Rr.”Dimitrije Tucoviç”, objekti banesor Vizioni, blloku IV, më datë 04.10.2019 rreth orës 14:00 si dhe në fshatin Muhoc, ku është vendosur material promovues-poster/baner reklamues në dimension të madh, fletushka dhe vizitkarta të kandidatëve Dimal Basha, Valon Ramadani, dhe Avni Tafili nga radhët e subjektit politik LVV, veprime këto të cilat sipas paraqitësit të ankesës përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit dhe rregullit zgjedhor, rrezikojnë cenimin e sigurisë juridike për qytetarët dhe padrejtësisht identifikohen politikisht si pasojë e veprimit në shkelje ligjore dhe të krijojnë precedentin e veprimit nga subjektet tjera politike. Sa i përket bazës ligjore, paraqitësi i ankesës, argumentet e tija i ka mbështetur në nenin 33 pika b) të LZP-së, duke kërkuar në fund që subjektet politike LDK dhe LVV, të sanksionohen për shkeljet e bëra. Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara, për këto arsye:

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.335/2019, Anr.336/2019, Anr.337/2019, Anr.338/2019, dhe Anr.339/2019, të gjitha të datës 07.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha ankesave është subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dhe poashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjekteve politike Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të dyja me seli në Prishtinë, prandaj Paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, andaj Paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë bërë vendosje të materialit promovues politik-poster/baner reklamues, fletushka dhe kartëvizita, në ndërtesën e banimit kolektiv në pronësi private, pa lejen e pronarëve.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë vendosur në hapësira private pa lejen e pronarëve, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ankesë, andaj Paneli nuk gjeti se ka ndonjë bazë për sanksionimin e subjekteve politike LDK dhe LVV.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.335/2019 më datën 07.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.